


Aksidentet Rrugore

Nëntor 2019

Tiranë, më 23 Dhjetor 2019: Në muajin Nëntor 2019 numërohen 109 aksidente rrugore nga 130 aksidente të ndodhura në muajin Nëntor 2018, duke u ulur me 16,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në njëmbëdhjetëmujorin e 2019, numërohen 1.363 aksidente rrugore nga 1.582 aksidente të ndodhura në njëmbëdhjetëmujorin e 2018, duke u ulur me 13,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Nëntor 2015 – Nëntor 2019



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në muajin Nëntor 2019, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 144 persona nga 171 që ishte një vit më parë, duke u ulur me 15,8 %. Numri i të aksidentuarve në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019 është 1.857 persona nga 2.129 persona, duke u ulur me 12,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Në muajin Nëntor 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 21 persona nga 22 persona të vdekur në Nëntor 2018. Në njëmbëdhjetëmujorin e 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 203 persona nga 190 persona në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Nëntor 2019, aksidentet rrugore në 76,1 % të rasteve kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup-mosha 25–34 vjeç, duke zënë 32,1 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup-moshë janë ulur me 22,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në njëmbëdhjetëmujorin e 2019, aksidentet rrugore në 15,2 % të rasteve kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur 33,4 %, krahasuar me një vit më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore

Periudha	Aksidente Gjithsej	Të vdekur		Të plagosur	
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Nëntor-2018	130	3	19	49	100
Nëntor-2019	109	5	16	47	76
Ndryshimi vjetor (%)	-16,2	66,7	-15,8	-4,1	-24,0
Janar–Nëntor 2018	1.582	36	154	649	1.290
Janar–Nëntor 2019	1.363	54	149	496	1.158
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-13,8	50,0	-3,2	-23,6	-10,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Nëntor-2018	98	32	16	6
Nëntor-2019	83	26	15	6
Ndryshimi vjetor (%)	-15,3	-18,8	-6,3	0,0
Janar–Nëntor 2018	1.271	311	148	42
Janar–Nëntor 2019	1.156	207	176	27
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-9,0	-33,4	18,9	-35,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	0 - 24 vjeç	25- 34 vjeç	35- 44 vjeç	45-59 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Nëntor-2018	24	45	27	22	6	6
Nëntor-2019	31	35	10	24	4	5
Ndryshimi vjetor (%)	29,2	-22,2	-63,0	9,1	-33,3	-16,7
Janar–Nëntor 2018	323	446	282	323	112	96
Janar–Nëntor 2019	285	406	236	264	106	66
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-11,8	-9,0	-16,3	-18,3	-5,4	-31,3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Nëntor 2018	Nëntor 2019	Nëntor 2018	Nëntor 2019	Jan.-Nën. 2018	Jan.- Nën. 2019	Jan.-Nën. 2018	Jan.-Nën. 2019
Shqipëria	130	109	22	21	1.582	1.363	190	203
Tiranë	50	48	2	5	671	583	38	46
Durrës	17	15	6	6	194	115	19	32
Shkodër	4	2	1	1	34	21	22	16
Elbasan	14	7	4	1	114	78	24	21
Fier	12	7	0	2	123	121	28	31
Vlorë	4	3	1	0	113	71	6	7
Korçë	6	7	3	0	80	102	9	15
Lezhë	15	8	4	3	128	146	18	18
Berat	2	2	0	1	39	23	5	3
Kukës	3	2	1	0	23	33	8	5
Dibër	0	2	0	1	26	14	8	6
Gjirokastrë	3	6	0	1	37	56	5	3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore si: ndryshimin në numrin e aksidenteve mujore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet në lëvizje, duke rezultuar në të paktën një person të vrarë ose të dëmtuar. Aksidentet në vendin e punës, depo janë të përjashtuara.

I vdekur: I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

I plagosur: I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit : Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj,

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: kalim rruge pa kujdes, etj,

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu link-ut: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).